

Jezusi fjala e Zotit

sipas Ate Gjergj Fishtes, perpunuar nga Gjovalin Gjoni

Aktoret jane te shtrire, permbysh me velon siper, ku duken si gure. Mbi nje sfond te shtruar si toke natyrale. Shoqeron nje muzike simfonike e marre nga koralja e “ e n i g m e s ”.

Kleriku ose magnetofoni

1. Kenga e pare (Shenjta nate)

2. Vijn Muzika e krishtlindjes 1

Kleriku ose magnetofoni _fjala e zotit. (sfond muzikor)

Kleriku: ate bote toka nuk ishte
as s'ishte hana as dielli,
as moti s'kish xane filli
as jeta nuk kisht le,
kur sparit fjala u ndi,
e t'madhit Perendi

(ketu fillon e ndriçohet skena nepermjet dy projektoreve).

Magnetofoni _ po, se njat here u shtruh
permbysh rathe t'vet qiella,
e hana e hyj e diella
filluene me flakrue,

e tokes iu vune themelet
e u ngrehen n'kambe zabelet.

Kleriku _ po, atebote, mbas asaj fjale
u nisen stinet e reja,
e sparit shkrepri rrefta (efekt – gjame e vetime)
lulzune fushe e male,
n'det gjemoi vala e gjiri
e shtasa u ba e njeri. (aktoret ngrihen me batutat perkatese)

A. O e amshuemja fjala e Zotit, (ngrihen ne gjunje me koke nga qielli)
C. Qi porsa nji here kumbove,
B. _ nji rruzullim shestove,
A. _ e ligje i vune motit,
B. _ kush din ç'fuqi ke n'veti?
C. _ se deri ku t'mbrrin pushteti?
A. _ s'e din e jona dija
B. Por qiella, toka e ferri, (ngrihen ne kembe)
por drita, moti e terri,

- e dine ku t'mbrrin fuqia!
C. kah urdhnit tand perkulen,
 prej t'cilit n't'kenun dulen,
 prej kah u lshue nji force e re (*aktoret ne levizje*)
A. per ty flet nata e dita (batutat ne levizje)
B. dimni acarr e zhegu,
C. e vala e argjende e bregu,
D! e vesa kur çile drita.
A! Flet per ty filladi i eres,
B. per ty flet zogu i veres.
C. per ty flet qiella e toka.
D. O fjale, rregulluese e motit,
 Ushto pra , n'zemrat tona,
 qi te zhyem nder faje drona
 Mnine e flakrueme t'Zotit
A Por ti nder rruge t'pendimit
 na i çil ti dyert e gzimit!
(efekt ndriçimi, me prozhektor pistolette ne cep te skenes)

3. Kenga Verbum panis

- Kleriku** Cka kane ra mbrame do valle?
 qe atje larg? Kah Nazareti! Kane jehue per male e zalle
B. po thone Anes e Joakinit,
C. se I hyll vajze u paska le,
D. si ajo drita prej agimit le,
A. si ajo vesa e nadjës s're
B. syni i saj nje rreze diellit,
C. shtati i saj gjeth drandofillit
D. nji prandvere ne blerim te vet. (*del vajza e Nazaretit*)
B. Izralei pat plot bija
 n'shej kjen n'shekull e porsi bora
 Ia shkrepse syni sikur zana
A por, si kjo, nuk duel kurnjana,
 As kah hiri, as kah pashija,
 emen te bukur edhe Nana
 Kesaj i ka njite, tue quejt: Marija

4. Kenga Mbretereshe

5. Vijn Muzika Krishtlindja 2

- Kleriku.** Ishte nadjë, vasha e re,
 Bukuri porsi prandvera,
 n'truell t'nji rregji vorfen le,

pa e ndie kush veç Zoti e era,
rrite t'lumin tuj e lutun,
ndoshta kobin per me e zbutun
qi i randote fisit t'vet

(engjelli paraqitet para Zojes)

“Kur qe hapen dyert e qiellit
E nji Engjell fletesh s'prarueme,
Asaj vashe ja beh ne shpi
e I thote Engjulli:

Engjulli

“Falemi Mri”

Lajmi i Zotit me ty flet **(ne gjunj. Efekt muzikor)**

Kleriku-magne

Puer m'mgujimet t'nalta empirit
Ati I drites kete bij e paka,
Edhe nane m'ia zgjedhe te birit
n'fllad t'dashnise se vet ai daka
kaq ju duk'ka synit t'tij
sa me e dashte n'gjak e n'gjini
n'gjini njerin me nji Zot! **(engjejt athere marrin flturimin)**

A.

Njaj, qi n'dor mban rruzullimin,

B.

e per nane ai te ka shenjue,
n'krahnuer tand per me u mishnue.

C.

fjalën tande qiella pret. **(ketu fillon vallja, efekt muzikor)**

D.

duelen engjujt n'per vegim,

B.

ejt po marrin fluturim. **(vallja e engjujve)**

A.

Ndejen pezull hana e diella?! **(muzike e ftohte heshtje sfond)**

B.

shuejti bota gjame e ankime?!

Zhurma e ferrit edhe ndalet?!

D.

tuj prite pezull se ç'fare fjalet,
ajo vashe e re po qet

Kleriku

zani i vashes u ndie aso here

Vajza

“bift mbi mue si asht fjala e jote,

Perendia si e premtoi!”**(GONG)**

Ndalet muzika Krishtlindja 2

Kleriku

E qe, krisi qiellve kanga! **(Engjujt, vallja e kenga-muzike)**

Ma permallshem lulezoi toka

Luciferi u struk n'pranga ,

ushton prej detit boka

C.

e prej ka lene e ku merr dielli

nji ylber i ndezyt ushtri

(ndriçim me leter me ngjyra) fiken dritat

Kleriku Mag

pengu i beses, qe lidhte qielli,

e nji rreze e Perendise
si kje fjala e Izaise
n'krahruer t'lumin ia perftoi. *(efekt muzikor)*
(Zoja ne skene me Jezusin para duarsh, e ndriçuar- efekt muzikor)

6. Kenga Krishtlindje

- B.** Mbar natyren ti hyjnove *(aktoreve ne gjunje me drejtim nga Zoja)*
A. prandaj ty, qi je pasqyra
E asaj mende, kah rrjedh jeta
Ure – pervuja t'nderon natyra
B. Dielli t'veshe me rreze t'veta
Shkam nene kambe te bahet hana,
C. Edhe yjet t'rrin nen pushtet
E na t'vorfnit bashk me ejt
A. t'quejme mbretneshe n'lumni qiellore
D. Vashe, te quen Shpirti Shejtnuesi,
B. Nane, te quen Biri shembuesi,
B. Ati i drites Bijë te thretet.
(muzik – korale recitativën ne gjunj. Te gjithë)

- A.B.C.D** t'falna, Mri! Nana e Tenzot! *(gong muzikor)*
A. deh! Pra, ti o rrigjinesha e rruzullimit,
C. Ata! t'ut sy te meshirshëm prej nesh sielli!
B. e nierit t'ngate, qe kjane n' ket fushe mjerimit,
ma t'bardha dit ti kthielli!
C. Shtrije edhe doren mbi keto malet tona,
B. e nper rreze t'amshueme t'ungjillit
D. na prij atje, ku na me u gjetun dona
A. nder t'blerta vrrije t'qiellit! *(fiken dritat – muzik, gong)*

- Kleriku:** O e shenjtueshmja Zoja Mri
Prej t'amshuemit mbushe me hire
Gjithone virgjen plot urti
Nane e dhimshme e fatmire
C. Birin tand per ne ti lute
D. Mnin e tij mbi ne deh zbute
Qi n'Parriz t'gzojm t'bardhin fat!

7. Finalja Kenge parapam!